



Σ = 47000

1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Adresa: Lagja .Nr.1 blloku "Tafil Skendo" Kuçovë www.bashkiakuçove.gov.al

KONTRATË

OBJEKTI: RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES Nr.1, BLOKU "11 JANARI"

KUÇOVË

Nr. 103 prot.


Kuçovë më, 23/06/2017

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA KUÇOVË

KRYETARI

Selfo KAPLLANI




Kontraktuesi

PERFAQESUESIT LIGJOR

"BESTA" SHPK

Robert ZYKA



"SHKELQIMI 07" SHPK

Shkelqim KAPLLANAJ



KONTRATE

OBJEKTI RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES Nr.1, BLOKU "11 JANARI"

Kjo kontrate lidhet sot ne date 23 /06/2017, ndermjet **Autoritetit Kontraktor: Bashkia Kucove**, me adrese *Lagjia nr 1 bloku Tafil Skendo Kucove* perfaqesuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor **Z. Selfo Kapllani** me poshte i quajtur "INVESTITOR" dhe

SIPERMARRESI: "BESTA" SHPK & "SHKELQIMI 07" SHPK te regjistruara si shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ku "BESTA" SHPK NIPT: J62903182B, me adrese: Berat Ura- Vajgurare Njesia Administrative Poshnje ,Ndertesa dy kateshe , kati i dyte , perfaqesuar nga administratori :**Robert Zyka**

&

"SHKELQIMI 07" SHPK me NIPT: K68121808W ,me Adrese: **Fier-Qender Mallakaster Belishove Rruga Nacionale Ballesh Fier**,perfaqesuar nga administratori: **Shkelqim Kapllanaj**.

OBJEKTI I KONTRATES: Kryerja e punimeve me objekt: Rikualifikimi Urban i Lagjes Nr.1, Blloku "11 Janari".


BAZA LIGJORE : Kjo kontrate mbeshtetet ne nenin 850 dhe ne vazhdim te Kodit civil te R.Sh-se, te ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik". I ndryshuar ,V.K.M.nr 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" (me ndryshime).

VLERA E KONTRATES : 120 316 298 (njqinde e njezet milion e treqinde e gjashtembedhjet mije e dyqinde e nentedhjet e tete) leke pa TVSH ose 144.379.557 (njqinde e dyzet e kater milion e treqind e shtatedhjet e nente e peseqinde e pesedhjet e shtate) leke me TVSH.

AFATI I KONTRATES : Kontrata do te realizohet brenda 6(gjashte) muajve nga data e fillimit te punimeve, sipas grafiku te punimeve realizuar nga drejtoria urbanistike, Bashkia Kucove. Punimet do te fillojne pas dorezimit te sheshit te ndertimit dhe marrjes se lejes se ndertimit nga investitori.

AFATI I PAGESES: Pagesa per punet e realizuara do te behet brenda 30 (tridhete) diteve nga data qe sipermarresi paraqet nje dokument (situacioni) qe deklarlon se objektivi per pagesen eshte arritur, subjekt ky i konfirmimit nga drejtuesi i projektit. Nese Autoriteti Kontraktor, nuk ben pagesen sipas grafikut te percaktuar me siper, sipermarresit i lind e drejta te nderprese punimet deri ne momentin e fillimit te financimit. Ky afat nderprejje nuk perfshihet ne afatin e pergjithshem te kontrates.

GJUHA E KONTRATES: Gjuha ne te cilen perpilohet kontrata eshte gjuha shqip.



A handwritten signature in black ink, appearing to be "Z. Selfo Kapllani".

A second handwritten signature in black ink, appearing to be "Shkelqim Kapllanaj".

KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojnë Kushtet e veçanta të kontratës.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është **BASHKIA KUÇOVË**
- 1.2 Kontraktori është Bashkimi i Operatoreve **"BESTA " SH.P.K + SHKELQIMI 07 "** SH.P.K

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej (10% të vlerës së ofertës me tvsh) prej 14.437.955 (njemilion e katerqind e tridhjetë e shtatë mijë e nentëqind e pesë) leke duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: **Pas 30 diteve te marjes ne dorezim te punimeve sipas kushteve te kesaj kontrate. Sidoqofte 5% e vleres se sigurimit te kontrates, do te zhblokohet pas përfundimit te garancise se objektit e cila eshte nje vit pas përfundimit te punimeve.**

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: Z. Ing. Bashkim LAME
- 3.2 Adresa/pika e kontaktit: Poshnje-Ura-Vajgurore (PRANE SHKOLLES SE MESME)

Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i vendodhjes së objektit që do të realizohet):

Lagjja Nr .1. Blloku 11 Janari, Kuçove.


Neni 5 Data e Fillimi

- 5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: nga data e nënshkrimit të Kontrates, nga te dyja palet.

Neni 6: Siguracioni

- 6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej: Sipas legjislacionit në fuqi.
 - a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: _____
 - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: _____
 - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____
 - d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: _____

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet



7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: Matje te volumeve, testime te betonit, testime te qendrueshmerise se rrethimit, etj.

Neni 8: Lloji i Kontratës

- 8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një
 - Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
 - Kontratë me Shumë Totale – JO

Neni 9: Grafiku i Pagesës

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: Ne baze te Vendimit nr. 8, date 13.2.2017 “Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I” dhe shkreses te ardhur me nr.2456/3 prot, date 06.03.2017 nga Ministria e Finances Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit , Drejtoria e Financave Vendore per vitin 2017 do te likujdohet vlera prej 44.201.005 (dyzet e kater milion e dyqinde i nje mije e pese) leke. Pjesa e mbetur nga vlera e lidhur e kontrates, do te likujdohet sipas vendimit nr. 8, date 13.2.2017 te Komitetit te Zhvillimit te rajoneve ne vitet ne vazhdim.

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda **30(tridhjetë) ditëve** nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë **Lekë**. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.


9.4 Pagesa dot e behet ne llogarine e Kontraktuesit “BESTA” SHPK sipas marrveshjes se palve :

Emri i bankes: **RAIFFEISEN BANK**


Nr. i Llogarise: 0700001111 me Nr IBAN AL15202230070000000700001111

9.5 Faturat duhet te jene te plotësuar sipas legjislacionit ne fuqi

**Autoriteti Kontraktor
BASHKIA KUCOVE
KRYETARI
Selfo KAPLLANI**



**Kontraktuesit
“BESTA” SHPK
Perfaqesuesi ligjor
Robert ZYKA
“SHKELQIMI 07”**



**Perfaqesuesi ligjor
Shkeqim KAPLLANAJ**

